

**KRIZA E DEMOKRACISE BRENDA PARTIVE:
RASTI I ZGJEDHJEVE NE PD 22.07.2017**

HYRJE

Kushtetuta e Shqipërisë (1998) neni, 9, sanksionon parimin demokratik se “partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike”. Ligji organik mbi partitë politike (ligji 8580/2000, i ndryshuar) i përkufizon partitë politike si “bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit”. I njëjti ligj, neni 7, parasheh në rastet e ndalimit me ligj të një partie politike, kur “organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t’u zgjedhur”.

Vetë partitë politike operojnë mbi bazën e rregullave të shkruara, të sanksionuara në Statutet e tyre, të depozituara në Gjykatë. Sipas statutit të PD (2014), neni 8, “funksionimi i PD bazohet në demokracinë e brendshme, e shprehur përmes votës së anëtarëve të saj. Vota e përfaqësuar u njihet vetëm përfaqësuesve të mandatuar prej anëtarëve. Rregullat e funksionimit të demokracisë në parti përcaktohen me akte të nxjerra nga organet qendrore të saj sipas parashikimeve të këtij Statuti”. I njëjti parim gjendet edhe në statutin e PS, të LSI dhe të partive të tjera politike.

Për shkak të mbi-pushtetit dhe rolit specifik që partitë politike kanë në sistemin tonë përfaqësues (ato emërojnë/përzgjedhin deputetët, kryetarët e bashkive, këshilltarët, funksionarët e lartë politikë, Presidentin, indirekt edhe funksionarët e institucioneve kushtetuese dhe administratën publike, etj), ekzistenca e partive politike demokratike është parakusht për demokraci jashtë tyre, për shtetin dhe shoqërinë. Në debatin për standarde më të larta të demokracisë funksionale dhe për zgjedhje të lira, të drejta dhe të ndershme, vend thelbësor luajnë edhe standardet që aplikohen brenda vetë partive politike. Nëse partitë politike dështojnë të jenë demokratike nga brenda shanset që ato të prodhojnë demokraci jashtë tyre janë vetëm teorike.

Bazuar në pozitën kushtetuese e ligjore, rolin në sistemin përfaqësues dhe rëndësinë që kanë partitë për ecurinë e procesit demokratik në Shqipëri, është me interes të shihet situatë brenda vetë partive politike, - proceset e tyre zgjedhore dhe vendimmarrëse. Partia Socialiste (PS) ka zhvilluar procese zgjedhore më 2009 dhe 2016. Më 2009 kryetari Rama, i cili sapo humbi zgjedhjet parlamentare, rivalizoi përballë një kandidat formal në garë, duke siguruar mbështetjen absolute të militantëve partiakë. Më 2016 kryetari Rama, tashmë fitues i zgjedhjeve dhe kryeministër, refuzoi të zhvillojë zgjedhje të rregullta në parti, duke thirrur një referendum partiak mbi mandatin e tij. Në shumicë absolute militantët dhe mbështetësit socialistë konfirmuan mandatin e tij të pakufizuar.

Në PD zgjedhjet e fundit partiake datojnë më 2013, pas humbjes së zgjedhjeve parlamentare. Megjithatë, pas humbjes së thellë të zgjedhjeve parlamentare 2017, pritej që PD të zhvillonte një

proces zgjedhor shumë më konkurrues dhe testues për aftësitë e saj për të prodhuar standard më të larta zgjedhore dhe demokracie sesa standardet kritike që u aplikuan një muaj më parë, në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri.

Pikërisht për shkak të ngjashmërive dhe ndikimit në jetën politike, ky studim analizon ecurinë e dy proceseve të fundit zgjedhore në PS dhe në PD, me fokus kryesor zgjedhjet në PD (22 korrik 2017). Teza kryesore e studimit është se në partitë tona politike po humbet nocioni i demokracisë së brendshme konkurruese dhe se baza militante partiake vijon të jetë përcaktuese në vendimmarrjet politike, mbështetëse e pakushtëzuar e liderëve të fortë politikë dhe e devijimit nga demokracia konkurruese në demokraci formale të personalizuar. Vetëm në vende para-demokratike si Shqipëria mund të ndodhë që kryetarët e partive që sapo humbin zgjedhjet, të votëbesohen në shumicë absolute për mandate të tjera drejtuese. Pyetja është: çfarë rezultati do të merrnin të njëjtët kryetarë nëse do të ishin fitues në zgjedhjet parlamentare? E kemi një përgjigje: Rama më 2009 mori mbi 93% të votave në parti kur humbi zgjedhjet parlamentare dhe rreth 94% të votave kur fitoi zgjedhjet parlamentare. Në PD, zoti Basha mori mbi 91% të votave të militantëve vetëm një muaj pasi kishte arritur rezultatin më të ulët historik të PD, vetëm 28% të votave kombëtare.

A janë këto rezultate tregues se partitë politike kanë sjellje elektorale dhe vendimmarrje të ndryshme nga sjellja elektorale dhe vendimmarrja në zgjedhjet parlamentare, apo kemi të bëjmë me procese të deformuara zgjedhore brenda partive politike? Të dhënat e studimit dëshmojnë për variantin e dytë: partitë dominohen nga kryetarët dhe mbështetësit e tyre besnikë, ato refuzojnë hapjen dhe praktikën demokratike të votimit konkurrues, nuk kanë mekanizma garancie brenda tyre dhe se rregullat funksionale (statutet, rregulloret, udhëzimet, etj), ndryshojnë në varësi të interesit politik të titullarit. Partitë, përfshirë PS e PD, nuk kanë regjistër anëtarësie të verifikueshëm dhe funksional, kanë fiktivitet në të dhëna dhe në vendimmarrjet e brendshme, nuk kanë “gjykata” statusore funksionale dhe nuk lejojnë fraksionet politike kritike brenda tyre.

ZGJEDHJET NË PD MË 22 KORRIK DHE PROBLEMATIKAT E PROCESIT ZGJEDHOR

Më 25 qershor 2017 PD shënoi rezultatin më të ulët historik në zgjedhjet parlamentare. Një muaj më pas, me 22 korrik 2017 PD zhvilloi zgjedhjet në bazën e saj për postin e kryetarit të partisë. Sipas praktikave të partive demokratike evropiane kur partia arrin rezultat negativ, madje rekord negativ, brenda saj ndodhin procese të shpejta reflektimi, analize, ndryshimi në lidhshmëri, në strukturë, në program dhe në sjelljen politike. Në PD-në e vitit 2017 nuk ndodhi asnjëra prej këtyre pritshmërive bashkëkohore. Më 27 qershor, 48 orë pas humbjes në zgjedhje, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, përmes një deklaratë publike tha *“kam vendosur të ngrij të gjitha funksionet e mija organizative si Kryetar i Partisë Demokratike dhe tua delegoj ato dy nënkryetarëve dhe sekretarit të përgjithshëm, për të organizuar me fuqi të plotë vendimmarrëse garën për kryetarin e Partisë Demokratike sipas*

parimit një anëtar një votë". Ai shtoi se *"kam një projekt dhe projektin tim do ta debatojnë dhe vlerësojnë demokratët në një debat dhe garë të hapur, të ndershme e të barabartë"*.

Një ditë më pas, me 28 qershor, dy nënkryetarët, Paloka e Spaho, shpallën vendimin për hapjen e garës për kryetar në PD dhe caktuan datën e zgjedhjeve, 22 korrik. Vendimi i tyre mbështetej në nenin 38 të statutit, i cili në të vërtetë nuk ka asnjë specifikim të tillë. Sipas këtij neni *"kryetari i Partisë zgjidhet me votim e të gjithë anëtarëve të PDSH, sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Modalitetet e procesit përcaktohen nga rregullorja e brendshme e PDSH"*. PD nuk ka rregullore për zgjedhjet dhe për pasojë, nuk ka asnjë modalitet zyrtar që mund të citohej dhe përdorej për rregullimin dhe jetësimin e procesit zgjedhor në parti. Dy nënkryetarët shpallën edhe datën e zgjedhjeve (22 korrik), një akt që nuk gjen mbështetje në asnjë prej neneve statusore në PD.

Akti i dy nënkryetarëve solli kritika brenda dhe jashtë PD. Paloka dhe Spaho, më 3 korrik dhanë një deklaratë tjetër, sipas të cilës *"procesi i shpallur i garës për kryetarin e PDSH është normal dhe bazuar në statutin e saj. Kryetari i partisë, bazuar në nenin 43, pika 2 ka autorizuar delegimin e të gjithë vendi-marrjes organizative tek të dy nënkryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm"*. Në fakt, neni i statutit i cituar përcakton se *"në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njeri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi (dorëheqje, etj.), Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar i cili komandon nënkryetarin që do të drejtojë Partinë deri në vendimin përfundimtar të Kuvendit Kombëtar"*. Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me *"mungesë të zgjatur"*, por me proces zgjedhor; kryetari nuk autorizoi një nënkryetar, por dy nënkryetarë, dhe se Sekretari i Përgjithshëm nuk mbledhi Këshillin Kombëtar për komandimin e nënkryetarit drejtues.

Brenda të njëjtës ditë dy nënkryetarët dhe sekretari i përgjithshëm pranuan thirrjen e mbledhjes së kryesisë së PD për të diskutuar gjendjen politike në parti dhe procesin tashmë të nisur zgjedhor brenda saj. Mbledhja e kryesisë trajtoi kërkesën e disa anëtarëve për dorëheqjen e kryetarit Basha, por në fund, me 14 vota, 11 kundër dhe 20 abstenime, kryesia nuk bëri asnjë ndryshim. Ajo zyrtarizoi dy kandidatë për kryetar, Lulzim Basha dhe Eduart Selami. Kryesia ngriti edhe Komisionin e organizimit dhe kontrollit të operacioneve elektorale (KOKOE) në përputhje me nenin 46 të statutit. Në krye të komisionit u emërua Jemin Gjana, i cili vetëm dy ditë më parë, më 1 korrik, përmes një interviste në media kishte sulmuar ashpër të gjithë kritikët e kryetarit Basha dhe kërkonte përjashtimin e tyre nga partia. Zgjedhja e tij në krye të komisionit zgjedhor de facto i humbi cdo element besimi paanësisë dhe profesionalizmit të mundshëm të këtij komisioni dhe paralajmëroi proces formal elektoral në zgjedhjet për kryetar në PD.

Akti i "ngrirjes" nuk është akt statusor dhe krijoi paqartësi në procesin zgjedhor brenda PD. Nga njëra anë zoti Basha nënkuptoi heqjen dorë nga ushtrimi i funksioneve, por tri ditë më pas, ai, me cilësinë e kryetarit të PD priti në takim drejtuesit e misionit ndërkombëtar të ODIHR. Njoftimi zyrtar u dha nga PD dhe faqja e saj zyrtare. Nuk pati reagim kritik as nga nënkryetarët e PD (ata ishin në krah të zotit Basha në takim) dhe as nga zoti Gjana me cilësinë e drejtuesit të komisionit elektoral.

- Gjithashtu, gjatë gjithë procesit zgjedhor në PD në muajin korrik, një numër zyrtarësh të lartë të PD, përfshirë administrata qendrore, zyra e shtypit, etj, dhanë deklarata publike në favor të zotit Basha dhe me tone shumë të ashpra, shpesh denigruese ndaj kritikëve të tij, përfshirë zotin Selami. Në asnjë rast as nënkryetarët, as sekretari i përgjithshëm, as komisioni elektorale nuk ndërhyjnë për të siguruar paanësi në proces, sipas premtimit politik dhe parimit statusor për *“garë të hapur, të ndershme e të barabartë”*.
- Rregullat zgjedhore dhe neutraliteti në proces u shkelën edhe në elementë të tjerë, psh, gjatë javës së parë të fushatës të gjitha njoftimet e shtypit mbi takimet u menaxhuan nga zyra e shtypit në PD, e cila dukshëm ishte në favor të kandidatit Basha.
- Po ashtu, në të gjitha zyrat e PD në Tiranë vijonin të qëndronin të ekspozuara foto dhe portreti i zotit Basha, me cilësimin, *“kryetar i PD”*, si dhe në disa degë, drejtuesit lokalë motivuan mbështetësit e tyre për të krijuar situara provokuese ndaj kandidatit rival, Selami. Incidenti më i rëndë ndodhi që ditën e shpalljes së kandidaturës së tij në selinë e PD, ku një punonjës partiak lëshoi kërcënime ndaj tij, por asnjë organ, përfshirë dy nënkryetarët, komisioni elektorale apo vetë zoti Basha, nuk e dënuan rastin dhe nuk kërkuan distancim prej rasteve të tilla.

Një nga problemet kryesore me të cilat u ndesh procesi zgjedhor në PD ishte cilësia dhe përmbajtja e Regjistrimit të Anëtarësisë. Sipas *statusit, neni 13/1*, në PD duhet të jetë i përditësuar Regjistri Bazë i Anëtarësisë, rregullat e administrimit të të cilit përcaktohen me vendim të Kryetarit të Partisë”. Neni 14 përcakton se nëse pas 60 ditësh anëtari nuk ka paguar kuotizacionin ai/ajo *“humb të drejtën e votës, deri në rinovimin e anëtarësisë”*. Pra, PD duhej të kishte Regjistrin Elektronik të Anëtarësisë, duhej të kishte sistem të pagesës së kuotave dhe anëtarë me të drejtë / pa të drejtë vote. Procesi zgjedhor i korrikut 2017 nxori në pah se asnjëri prej këtyre elementëve nuk ekzistonte. Për pasojë, u operua me masa *“të jashtëzakonshme”* duke i lënë dorë të lirë degëve dhe komisionit elektorale të përcaktonte anëtarët dhe të administronte regjistrin e munguar të tyre.

Më 4 korrik, KOKOE (Komisioni Elektorale) miratoi rregulloren emergjente për votimin e datës 22 korrik. Më parë, me 3 korrik, sipas vendimit të dy nënkryetarëve *“që nga data 28.06.2017 në PDSH nuk ka patur dhe nuk do të ketë anëtarësime të reja deri sa të përfundojë procesi i zgjedhjes së kryetarit të saj”*. Por me 4 korrik Komisioni Elektorale u dha të drejtën e regjistrimit të anëtarëve të tjerë deri më 12 korrik, kryesisht individë ish anëtarë, por që nuk figurojnë në regjistrimin e ri. Më 22 korrik Komisioni Elektorale njoftoi se Regjistri Elektronik përmban 103 mijë e 200 anëtarë. Sipas kryetarit Gjana, *“janë shtuar 1500 anëtarë në listat shitesë nga persona që janë paraqitur me karta anëtarësie por që nuk i kishin përditësuar, janë shtuar 112 anëtarë në 5 degë të PD-së, si dhe janë hequr nga regjistri elektronik 607 anëtarë që kanë kaluar nga subjekte të tjera politike si dhe 310 që nuk jetojnë më”*.

Që në fillim të procesit zgjedhor të 22 korrikut, një numër zyrtarësh të lartë të PD-së, përfshirë ish kryetarët Topalli, Patozi, Imami, ish ministrat Ruli, Mustafaj, Bregu, etj, si dhe rreth një e treta e kryesisë së PD-së, kontestuan procesin dhe kërkuan dorëheqje të plotë të zotit Basha nga posti i

kryetarit. Ata kërkuan analizë të thellë të humbjes zgjedhore dhe bënë përgjegjës zotin Basha për rezultatin negativ. Kërkesat e tyre të shprehura në formë mediatike, por edhe institucionale, përfshirë edhe ato për mbledhjen e Këshillit Kombëtar apo të kryesisë, nuk u morën në konsideratë nga zoti Basha dhe as nënkryetarët e komanduar prej tij. Për pasojë, ata deklaruan më 3 korrik se mbeten jashtë garës për kryetar në PD dhe i bënë thirrje të vazhdueshme anëtarësisë për bojkotin e “farsës” zgjedhore të 22 korrikut.

Në këto rrethana, zgjedhjet për kryetar në PD morën një rrjedhë tjetër:

- Kandidati i parë ishte zoti Basha i mbështetur nga e gjithë administrata dhe kryetarët lokalë (mbi 90% e tyre patën rezultate negative historike në zgjedhjet parlamentare 2017, ndaj mbështetjen për zotin Basha e konsideronin qëndrim në të njëjtën varkë të përgjegjësisë), shtypi zyrtar i PD, nga zoti Berisha dhe për shkak të marrëveshjes së 18 majit, edhe nga qeveria dhe partitë kryesore politike në vend.
- Kandidati i dytë ishte zoti Selami, pa mbështetje infrastrukturore në PD, kryesisht popullor tek brezi i viteve 90 dhe tek grupet liberale pakicë në PD dhe pa akses e njohje reale të bazës vendimmarrëse në PD.
- Pala e tretë, kritikët kontestues të procesit, të cilët refuzuan të kandidojnë në proces si dhe të japin mbështetje për zotin Selami, duke ndihmuar praktikisht në devijimin e garës zgjedhore për kryetar në një garë për pjesëmarrje apo bojkot të zgjedhjeve.

Që në fillim të procesit u bë e qartë se fituesi ishte paracaktuar dhe se zoti Basha mund ta fitonte garën për kryetar midis votuesve militantë që do të merrnin pjesë në votime. Ndaj vëmendja e tij kryesore dhe e mbështetësve të tij u përqendrua tek pjesëmarrja dhe administrimi i procesit zgjedhor. Pjesa më e madhe e komisioneve zgjedhore në nivel degësh ishin të emëruar midis mbështetësve të tij, dhe se edhe midis përfaqësuesve të kandidatit rival Selami u gjetën disa individë, disa prej të cilëve në fundin e procesit dukshëm nuk mbrojtën të drejtat dhe votat e kandidatit që zyrtarisht përfaqësonin.

Në funksion të pjesëmarrjes masive u përdorën të njëjtat mekanizma si në zgjedhjet parlamentare, - financimi i udhëtimeve për anëtarë nga zona e largët, udhëtime, pagesa, votime familjare të deleguara, dhe për më tepër, pati raste të shumta të fiktivitetit zgjedhor. Të dhënat filmike nga votimi në Vlorë, Korçë apo Durrës, treguan se numri i personave që hyri në qendrat e votimit ishte 2-3 herë më i vogël sesa numri i votave që zyrtarisht u tha se janë dhënë për kandidatin Basha. Gjithashtu u paraqitën pamje filmike të individëve që votuan më shumë se një herë, dhe në çdo rast, nuk pati asnjë reagim, verifikim apo masë nga Komisioni Elektorale apo dy nënkryetarët e komanduar të drejtojnë partinë.

Fokusi kryesor i një fushate partiake, - debati mbi programin, analizën dhe alternativat, - u la mënjanë duke i dhënë prioritet natyrës teknike të zhvillimit të zgjedhjeve, debatit mbi legjitimitetin e tyre dhe sulmeve verbale midis grupeve të caktuara, sidomos midis mbështetësve të zotit Basha


dhe mbështetësve të zotit Patozi. Ky ligjërim kritik politik u përshkallëzua në ligjërim denigrues dhe përjashtues politik, zhvillim që ishte në interes të dy grupeve por jo të procesit zgjedhor. Grupi pro Basha e përdori ligjërimin për të përgatitur ndarjen finale me kritikët publikë të tij, përfshirë dy ish nënkryetarët, si dhe duke u paraqitur si viktimë e sabotimit të zgjedhjeve parlamentare, kurse grupi pro Patozit e përdori ligjërimin për të delegitimuar procesin zgjedhor në PD dhe produktin e paracaktuar të tij.

Kandidati tjetër në garë zoti Selami, duke mos qenë pjesë e asnjërit grup dhe duke iu larguar mjeteve të luftës politike që përdorën dy grupet, *de facto* u la jashtë procesit zgjedhor, administrimit dhe monitorimit të tij. Ai vazhdimisht kritikoi pabarazinë në garë dhe paralajmëroi pasojat për një parti të madhe politike si PD, por nuk pati mjete dhe as hapësirë në dispozicion për të arritur të imponojë ndryshimin e gjendjes brenda PD dhe të vetë procesit zgjedhor.

PARTI ME SEMUNDJE TE NJEJTA? PD 2017 NJESOJ SI PS 2016

Referendumi i PS (2016) shënoi rekorde historike të mbështetjes së PS për kryetarin e saj dhe pyetjen e referendumit të propozuar prej tij. Të gjitha vendimet e rëndësishme në PS përpara vitit 2016 ishin marrë me shumicë votash, por me diferencë e konkurrim serioz midis alternativave e grupeve të ndryshme mbështetëse. Në një rast, kryetari i partisë fitoi me vetëm 36 vota diferencë përballë rivalit të tij, kurse në disa raste të tjera diferencat e vogla përcaktuan fituesin dhe humbësin e votimeve në KPD, në Kongres dhe në strukturat e tjera drejtuese.

Më 2016 grupi kritik ndaj referendumit nuk pati mundësi pjesëmarrjeje në administrimin e tij dhe as në monitorimin e procesit. Megjithatë, grupe civile arritën të monitorojnë të paktën tri votime, një në Vlorë, një në Tiranë dhe një në Durrës. Në secilin rast numri i qytetarëve që hynë në qendrat e




votimit (pavarësisht se cila ishte vota e tyre pro/kundër apo abstenim) rezultoi se ishte të paktën dy herë më i vogël sesa numri zyrtar që Komisioni Elektoral në PS shpalli për pjesëmarrjen në votim. Ky ishte një tregues i qartë i fiktivitetit të votimit dhe rritjes formale të pjesëmarrjes në votime, për të krijuar idenë e një partie të madhe popullore dhe të mbështetjes masive për kryetarin dhe referendumin e thirrur prej tij.

Referuar të dhënave zyrtare, pjesëmarrja më e ulët, por gjithsesi, mbi 74%, u shënua në qarqet Lezhë, Kukës e Gjirokastrë, kurse pjesëmarrja më e lartë (mbi 85%) u shënua në Shkodër, Dibër, Tiranë, Fier e Korçë. Madje qarku me pjesëmarrjen më të lartë ishte Shkodra, njëherësh qarku më bastion i të djathtës në Shqipëri. Edhe në votën pro referendumit Shkodra ishte dominuese, ndjekur nga Dibra, dy nga katër qarqet më të njohura të së djathtës gjatë tranzicionit 27 vjeçar në Shqipëri.

PARADOKSI: PD 10% MË SHUMË VOTA ME 22 KORRIK SESA ME 25 QERSHOR

Të dhënat krahasuese lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhjet e datës 22 korrik dhe krahasimi me pjesëmarrjen në zgjedhjet e datës 25 qershor 2017, nxorën në pah një paradoks domethënës: në 8 qarqe ka rekord pjesëmarrje në zgjedhjet në PD, në shumicën e tyre me përqindje shumë herë më të lartë sesa pjesëmarrja e demokratëve në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit. A kemi të bëjmë me motivim më të madh për të votuar në parti për kryetarin sesa në zgjedhjet parlamentare apo kemi të bëjmë me fiktivitet pjesëmarrje në rastin e zgjedhjeve partiake, - këto pyetje nuk kanë përgjigje të qartë.




Fakti është se në Korçë pjesëmarrja në zgjedhjet e 22 korrikut ishte rreth 26% më e lartë sesa më 25 qershor, në Lezhë 21% më e lartë, në Gjirokastrë ku demokratët fituan vetëm një mandat parlamentar pjesëmarrja më 22 korrik ishte rreth 16% më e lartë, në Elbasan ku PD shënoi rezultat minimal historik pjesëmarrja më 22 korrik ishte 15% më e lartë, në Vlorë gjithashtu me mbi 11%, në Dibër ku u morën vetëm dy mandate gjithashtu u shënua 10% më shumë pjesëmarrje.

I vetmi qark me tregues thujtse të njëjtë pjesëmarrje ishte Fieri, kurse qarqet me rënie në pjesëmarrje më 22 korrik në raport me 23 qershorin janë Durrësi, Berati dhe sidomos Kukësi. Në total, në nivel kombëtar në zgjedhjet e 22 korrikut në PD morën pjesë 10.7% më shumë zgjedhës sesa përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit.

FITORE E THELLE ME 22 KORRIK ATY KU PATI HUMBJE TE THELLE ME 25 QERSHOR

Të dhëna të tjera krahasuese midis rezultatit të votimeve në PD (22 korrik) dhe të votës në zgjedhjet parlamentare (25 qershor) nxjerrin në pah paradokse të tjera të sjelljes elektorale të bazës militante të PD-së. Konkretisht, tabela ilustron votën pro Bashës dhe votën pro PD në një muaj diferencë, duke pasur gjithnjë parasysh faktin se vota pro PD nuk është e vetme, por është e të gjithë opozitës së bashkuar. Për pasojë, diferenca reale midis votës pro Bashës dhe pro PD është shumë më e thellë sesa edhe vetë ilustrimi në tabelë.



Gjithsesi, duke e marrë të mirëqenë tabelën rezultojn se Basha ka shënuar sukses personal në parti në shifra rekord, në çdo rast mbi 80% të votave, ndërkohë që në zgjedhjet parlamentare rezultati kombëtar ishte vetëm 28% të votave. Referuar qarqeve, Basha shënoi sukses maksimal në Shkodër, zonën e vetme ku gjatë fushatës zgjedhore parlamentare dhe në PD pari realisht elementë të protestës së anëtarëve të PD kundër tij personalisht. Interesant është fakti se ashtu si Rama më 2016 edhe Basha më 2017 rezultatet e tyre maksimale i kanë pikërisht në qarkun Shkodër, një qark universitar ku standardet zgjedhore dhe cilësitë e përzgjedhjes do të duhej të ishin shumë më të larta sesa në disa prej qarqeve të tjera.

Vlen të theksohet fakti se edhe në qarqe me rezultate minimale në zgjedhjet parlamentare 2017, siç janë Elbasani apo Gjirokastra, fitorja e Bashës më 22 korrik ishte me rezultatet më maksimale.

“MODELI DEMOKRATIK” QË VJEN NGA PEQINI. BELSHI, SHIJAKU...

Midis rezultateve zgjedhore të datës 22 korrik një rezultat mbetet unik dhe madje, unik edhe për votimet në çdo parti politike dhe në Shqipërinë e periudhës postkomuniste. Në Peqin kanë votuar 555 anëtarë të PD dhe zoti Basha ka fituar 554 vota, pra vetëm 1 votë kundër, 0 vota abstenim apo të pavlefshme! I fundit rast kur Peqini ka pasur votim të tillë janë zgjedhjet e fundit të PPSH në vitin 1987.





Tabela ilustron rastet e votës “plebishitare” të zotit Basha në disa degë lokale të PD, shifra atipike për vende demokratike dhe për parti me organizim demokratik. Konkretisht, rekordin e kryeson Peqini me rreth 100% të vota pro Bashës, ndjekur nga Belshi me 99%, Kavaja 99%, Malësia e Madhe 99%, Memaliaj, Bulqiza, Vau i Dejës dhe Tirana 6 me nga 97%, si dhe Rrogozhina e Shijaku me nga 96%. Janë shifra të paimagjinueshme dhe natyrisht, vështirë të besueshme edhe në zërat më optimistë të rezultatit zyrtar.

Interesant është fakti se duke përjashtuar zonën 6 në Tiranë, të gjitha degët me rezultate maksimale janë kryesisht zona të thella të periferisë apo zona me 1000 probleme, ku nevojat për më shumë demokraci, shanse dhe përfaqësim janë shumë më të mëdha sesa në qytetet metropole. Interesant është gjithashtu fakti se në shumicën e këtyre zonave PD ka pasur rezultatet më negative në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit, madje kandidatë të saj që kanë konkurruar në zona të tilla kanë akuzuar edhe komisionerët e tyre të djathtë si të shitur tek e majta apo PDIU. Pavarësisht nga këto të dhëna me rëndësi, verdikti i tyre i jep legjitimitet rezultatit final. Për pasojë, në këto zona është prodhuar një standard i ri votimi, i cili përveçse dyshimet e arsyeshme për fiktivitetin e pjesëmarrjes dhe të votës, është edhe tregues i standardeve që partitë politike përdorin për ti imponuar më pas si standarde për suksesin dhe vetë shoqërinë shqiptare.

Tabela më poshtë publikohet për herë të parë dhe ilustron votat pro Ramës më 2009, - ku përsëri gjenden modele si dega e Shijakut, ku kryetari që humb zgjedhjet parlamentare fiton 99% në zgjedhjet partiake pasuese, ndjekur nga Puka dhe Lushnja me rezultat po ashtu maksimal.




DEMOKRACIA E 60 MINUTAVE TË FUNDIT

Një nga zhvillimet interesante më 22 korrik ishte edhe ndryshimi radikal i pjesëmarrjes në votime, sidomos në orët e fundit të votimit. Referuar të dhënave zyrtare të PD, prej të cilave zoti K. Islami publikoi edhe një tabelë dhe analizë ilustrative, rezulton se gjatë 60 minutave të fundit të votimit, përkatësisht midis orës 18:00 dhe 19:00 kanë votuar mbi 10 mijë anëtarë të PD dhe pjesëmarrja në votime është rritur gjithashtu me rreth 10%. Rritja më e madhe u shënua në Korçë e Dibër (13%), Tiranë e Vlorë (12%), Shkodër e Fier (9%), etj.

Duke i marrë të mirëqenë shifrat dhe dyndjen e minutave të fundit për të votuar për kryetarin Basha, është bërë një përlogaritjeve e sekondave për votë në secilin prej qarqeve.

Nga tabela rezulton se Durrësi është qarku më “dembel” me një votues në çdo 20 sekonda, ndjekur nga votuesit në Kukës me një votues për 18 sekonda. Rekord shpejtësie votimi ka në Korçë, ku rezulton se çdo 3.6 sekonda ka pasur një votues, në Dibër çdo 4,8 sekonda, në Vlorë çdo 6,2 sekonda, në Fier çdo 7,4 sekonda, etj. - një kohë e pamundur të imagjinohet.

Vetëm hyrja e personit në sallën e votimit, gjetja e emrit, pajisja me fletëvotimi, votimi në dhomën e fshehtë dhe më pas votimi në kuti, kërkojnë minimalisht 30 sekonda, - një shifër shumë më e lartë sesa numri i sekondave që kanë dashur të votojnë mbi 10 mijë zgjedhës në orët e mbrëmjes së datës 22 korrik.



SISTEMI JO PËRFAQËSUES I ANËTARËSISË NË PD

Një nga treguesit e çdo partie politike është natyra proporcionale e shtrirjes së saj sipas votave, mbështetjes dhe interesit. Për shembull, në Gjermani apo në SHBA e Britani nuk mund të imagjinohet që një degë lokale me vullnet maksimal për të pasur anëtarë partie, por që nuk ka peshë specifike në votën kombëtare të partisë të ketë përfaqësim të njëjtë vendimmarrës me degë të qyteteve kryesore, të cilat kanë peshën përcaktuese në zgjedhjet parlamentare dhe në peshën e përfaqësimit politik të partisë.

Në rastin e zgjedhjeve në PD tabela e pjesëmarrjes në votime, referuar të dhënave zyrtare nga Komisioni Elektoral në PD, nxjerr në pah disa të dhëna interesante. Për shembull, degë lokale pa peshë në politikën kombëtare dhe përfaqësimin politik kanë shumë më tepër votues dhe anëtarë sesa degë lokale të qyteteve kryesore. Konkretisht, numrin më të madh të votuesve PD e ka në Kamëz, ndjekur nga Fieri e Shkodra. Vetëm dy vende më pas rezulton se dega lokale e Maliqit dhe e Devollit kanë më shumë votues në PD (më 22 korrik) sesa shumica e njësive bashkiake në Tiranë, sesa qytete si Vlora, Durrësi, Elbasani, Korça apo Kavaja. Për më tepër, në një degë si Maliqi, PD nuk ka fituar asnjë prej zgjedhjeve lokale prej më se dy dekadash, ndaj mbetet e çuditshme sesi ajo ka më shumë peshë vendimmarrëse në PD sesa edhe vetë bashkia e Korçës dhe e Durrësit.

Listës së paradokseve i bashkohen edhe raste të tjera të njëjta, p.sh, që Malsia e Madhe apo Bulqiza kanë më shumë peshë vendimmarrëse në PD sesa Vlora, Kavaja, Berati, Dibra apo Gjirokastra dhe që në Tiranë, njësia 5 ku PD nuk ka fituar asnjëherë ka vlerë votash shumë më të mëdha sesa mbi 45 degë të tjera lokale të PD-së, përfshira zona ku tradicionalisht ajo është fituese.

<u>Bashkia</u>	<u>Votues 22 korrik</u>	<u>Bashkia</u>	<u>Votues 22 korrik</u>
<u>Kamez</u>	4296	<u>Tirana 06</u>	1373
<u>Fier</u>	2040	<u>Tirana 08</u>	1348
<u>Shkoder</u>	2003	<u>M.Madhe</u>	1345
<u>Lezhe</u>	1893	<u>Bulqize</u>	1308
<u>Lushnje</u>	1647	<u>Diber</u>	1263
<u>Maliq</u>	1597	<u>Kavaje</u>	1218
<u>Devoll</u>	1535	<u>Kurbin</u>	1217
<u>Durres</u>	1530	<u>Gjirokaster</u>	1198
<u>Korce</u>	1476	<u>Tirana 05</u>	1134
<u>Tirana 04</u>	1475	<u>Mati</u>	1112
<u>Elbasan</u>	1463	<u>Vlore</u>	1095
<u>Tirana 11</u>	1451	<u>Paskuqan</u>	1009

Burimi: Instituti i Studimeve Politike www.isp.com.al 2017

Duke e zgjeruar analizën, për shembull, me numrin e anëtarëve të PD sipas qarqeve dhe numrit të mandateve parlamentare në Shqipëri, përsëri organizimi i PD tregon se ka mospërputhje midis gjendjes e prioritetëve në PD dhe gjendjes dhe interesit elektorale në Shqipëri. Konkretisht, qarqe si Vlora me 12 mandate kanë më pak anëtarë sesa Kukësi me 3 mandate apo Dibra me 6 mandate, për pasojë edhe më pak peshë vendimmarrëse në PD. E njëjta analizë vlen edhe për një numër qarqesh të tjera të ilustruara në tabelë.

Më tej, duke iu referuar mandateve parlamentare të marra nga PD në zgjedhjet 2017 dhe numrit të anëtarëve të partisë në qarqe, rezultojnë se numri i anëtarëve për 1 mandat parlamentar shkon nga 1695 në Vlorë e 1755 në Shkodër në 3900 në Fier dhe 4877 në qarkun Berat. Gjirokastra ka gjithashtu raport të lartë, prej 3587 vota anëtarësh për një mandat parlamentar, kurse Tirana ka raport 2756 vota anëtarësh për një mandat parlamentar.

Referuar numrit të votave të fituara nga PD në zgjedhjet e fundit parlamentare, rezultojnë se raporti midis anëtarëve dhe votave është minimal: nga 3,3 vota për anëtar në Berat në 5,4 vota për anëtar në Durrës. Qarqe si Shkodra, Lezha, Vlora apo Elbasani kanë pothuajse një raport të tjerë, 4,6 deri 4,8 vota për anëtar, kurse Tirana ka raport më të vogël, vetëm 4,2 vota për anëtar. Partitë tona janë zakonisht me identifikim familjar dhe familjet shqiptare janë zakonisht me nga 3-4 persona, ndaj supozohet se çdo anëtar partie ka pas tij 4-5 persona. Duke e marrë këtë shifër si bazë referimi atëherë rezultojnë se në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit 2017 pro listës shumë-emërore të PD kanë votuar vetëm anëtarët dhe familjet e tyre, madje në disa raste edhe më pak sesa kaq.

	ANETARE	PER MP	DEPUTETE	FITUAR	PER 1 MP	VOTA 2017	ANETARE-VOTUES
BERAT	4877	697	7	1	4877	16302	3,3
DIBER	5570	928	6	2	2785	21331	3,8
DURRES	7966	569	14	4	1992	43163	5,4
ELBASAN	6985	499	14	3	2328	33868	4,8
FIER	11718	732	16	4	3906	46799	4,0
GJIROKASTER	3587	717	5	1	3587	13321	3,7
KORCE	8140	740	11	4	2035	42177	5,2
KUKES	5105	1702	3	2	2553	19935	3,9
LEZHE	5820	831	7	3	1940	27550	4,7
SHKODER	8777	798	11	5	1755	40763	4,6
TIRANE	30314	892	34	11	2756	127997	4,2
VLORE	5093	424	12	3	1698	23207	4,6

Burimi: [Institut i Studimeve Politike www.isp.com.al](http://www.isp.com.al) 2017

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Zgjedhjet për kryetar në PD (2013 dhe 2017), zgjedhjet për kryetar në PS (2009 dhe 2016) si dhe në tërësi zgjedhjet e partive politike për kryetar me parimin “1 anëtar – 1 votë” përbëjnë deformim nga modeli dhe standardi klasik i votës nga anëtarësia. Ato vuajnë nga protagonizmi i kandidatit të paracaktuar, nga mungesa e shanseve për konkurrim real, nga mungesa e regjistrave të sakta të anëtarësisë, nga mungesa e organeve të besueshme menaxhuese të zgjedhjeve dhe nga fiktiviteti në pjesëmarrje dhe në votim.

Në partitë shqiptare një pakicë militante po merr shumë më tepër pushtet sesa shumica qytetare brenda e jashtë partive politike. Kjo pakicë militante, kryesisht pa formim politik e me defekte në formimin kulturor demokratik, refuzon zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të ndershme, imponon vendimmarrjet brenda partive dhe përmes tyre, imponon edhe sistemin e karrierës në parti, vendimet politike të partisë dhe sistemin gjithnjë e më vertikal të vendimmarrjes politike.

Zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit nuk shënuan hapa pozitiv në standardet zgjedhore, dhe një faktor me ndikim në këtë bilanc negativ, është edhe vetë gjendja e mjerueshme e demokracisë së brendshme në partitë politike. Standardet e zgjedhjeve brenda partive politike janë po aq problematika, madje në disa aspekte më formale dhe fiktive sesa edhe zgjedhjet parlamentare e lokale në Shqipëri.

Zgjedhjet e 22 korrikut në PD nuk ofruan zgjidhje, dështuan të ofrojnë standarde më të larta zgjedhore sesa në partitë e tjera dhe përbëjnë një humbje tjetër në cilësi e besim publik të njëjtë me humbjen me rekord negativ historik më 25 qershor 2017.

Zgjedhjet jodemokratike brenda partive politike nuk sjellin demokratizim të partive dhe as hapje të tyre, modernizim apo forcimit të alternativës politike. Përkundrazi. Ato krijojnë përçarje dhe ulin besimin publik të qytetarëve tek partitë dhe të vetë anëtarëve të partive tek forca udhëheqëse dhe reformatore e lidhshpirt partiak. Zgjedhjet e fundit në PD janë dëshmi e kësaj teze.

Legjislacioni i partive politike përcakton rregulla e parime të organizimit dhe funksionimit të partive politike, por nuk parashikon mekanizma monitorimi dhe ndërhyrje për të garantuar këto rregulla e parime. Përmirësimi i ligjit dhe ngritja e instrumenteve të garancisë mund të përbëjnë një hap me rëndësi në drejtim të rritjes së legjitimitetit përfaqësues e funksional të vetë partive politike.

Partitë politike, sidomos PD e PS, kanë nevojë emergjente për reformim të bazës ligjore funksionale, - statusin, programin, rregulloret, etj, për të krijuar një bazë solide ligjore funksionimi dhe mekanizma garancie për më shumë demokraci funksionale brenda tyre.

Proceset zgjedhore në partitë politike kanë interes publik, sepse partitë janë institucione publike e ligjore, financimi i tyre bëhet me taksat tona, vendimmarrja e tyre lidhet me jetën tonë. Për këtë arsye proceset zgjedhore brenda tyre duhet të jenë të hapura për grupet monitoruese civile dhe median, për të ofruar një standard transparencë të njëjtë me atë që partitë vetë promovojnë në programet e tyre politike.